



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: \_\_ Dhjetor 2020

Nr: ----

**PROJEKTVENDIM**

**PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË DHOMËS SË FSHEHTË QË DO TË PËRDORET NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafin 2, nenin 99, paragrafi 2, shkronja “c”, nenin 100, paragrafi 1 shkronja “ç”, dhe nenin 101, paragrafi 1 shkronja “a” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur,

**V Ë R E N:**

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për miratimin e specifikimeve teknike të materialeve zgjedhore që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin t’i dërgojë Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për qendrat e votimit nën juridiksion.

Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, dispozitave si më poshtë referuar:

- neni 99, paragrafi 2, shkronja “c”, përcakton se “KQZ dërgon në KZAZ numër të mjaftueshëm dhomash të fshehta”;
- neni 100, paragrafi 1, shkronja “ç” përcakton se KZAZ-ja u shpërndan në KQV nën juridiksionin e saj dhomat e fshehta;



Data: \_\_ Dhjetor 2020

Nr: \_\_\_\_\_

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

c) neni 101, paragrafit 1, shkronja “a”, përcakton detyrë të KQV-së përgatjen e qendrës së votimit: “vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve.”

Referuar eksperiencës të organizimit dhe administrimit të proceseve zgjedhore, dhomat e fshehta, sipas specifikimeve teknike të miratuara nga KQZ, kanë garantuar fshehtësinë e votimit, si dhe kanë qenë të përshtatshme për zgjedhësin gjatë shënimit të fletës së votimit.

Modeli i dhomës së fshehtë prej kartoni, me pjesë mbështetëse, i përdorur në zgjedhjet e mëparshme, është provuar të jetë lehtësisht i montueshëm, si dhe mund të vendoset kudo brenda mjedisit të qendrës së votimit në funksion të organizimit të Qendrës së Votimit për të garantuar fshehtësinë e votimit.

Për grupe zgjedhësish me aftësi të kufizuara, para dhe tetra plegjikë, modeli i dhomës së fshehtë duhet të jetë i përshtatur për nevojat e tyre. Modeli i dhomës së fshehtë i përshtatur për nevojat e zgjedhësve që i përkasin këtij grupimi, i konsultuar edhe me organizata civile përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara, i mundëson këtyre zgjedhësve të ushtrojnë vetë të drejtën e votës, duke garantuar fshehtësinë e saj.

Materiali prej kartoni për prodhimin e dhomave të fshehta, sikundër është përdorur në proceset zgjedhore pararendëse, është rezistent në përdorim, transportohet dhe montohet lehtësisht, dhe krijon lehtësi për organizimin e qendrës së votimit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafin 2, nenin 99, paragrafi 2, shkronja “c”, nenin 100, paragrafi 1, shkronja “ç” dhe nenin 101, paragrafi 1 shkronja “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhomat e fshehta do të jenë sipas modeleve dhe specifikimeve të përcaktuara në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.



Data: \_\_ Dhjetor 2020  
Nr. \_\_\_\_

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: \_\_ Dhjetor 2020  
Nr. \_\_\_\_

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për  
Kuvend të datës 25 prill 2021

## LIDHJA 1

### Modeli I



#### **Specifikimet:**

Lartësia: 150 cm  
Lartësia e mbajtëses: 100 cm  
Përmasat e suprinës:  
Gjerësia: 54 cm  
Thellësia: 60 cm  
Materiali:  
Karton trashësia 5mm (5 shtresa)

#### **Karakteristika:**

Rezistente ndaj lagështirës  
E palosshme

### Modeli II

(dhoma e fshehtë e përshtatur për zgjedhësit më aftësi të kufizuara)



#### **Specifikimet:**

Lartësia: 80 cm  
Përmasat e suprinës:  
Gjerësia: 60 cm  
Thellësia: 50 cm  
Materiali:  
Karton 5mm (5 shtresa)

#### **Karakteristika:**

Rezistent ndaj lagështirës  
E palosshme

**Kartoni i dhomave të fshehtësisë është i bardhë.  
Në pjesën balllore stampohet stema e Republikës së Shqipërisë.**